




Të nderuar kolegë,

Për shkak të formatit të komunikimit të kërkuar këtë here, jam i shtrënguar t'u drejtohem shkurt, në pak fjalë, rreth Angazhimit që kërkoj të marr sepse vlerësoj kohën dhe vëmendjen tuaj.

Unë jam **Albion Ndini**, prej vitit 2006 ushtroj profesionin e kontabilistit, prej viti 2019 anëtar i Institutit dhe aktualisht po **kandidoj për Anëtar të Këshillit Drejtues** në zgjedhjet që do të zhvillohen në Asamblenë e Përgjithshme.

Vij nga përvoja e një zyre të mesme, ku sfidat janë konkrete dhe kontaktet me kolegët i kam të përditshme. Kjo më ka mësuar të vlerësoj bashkëpunimin, ndjeshmërinë profesionale dhe respektin reciprok që forcon komunitetin tonë.

E shoh **rolin institucional të IEKA-s**, si një aktor të rëndësishëm dhe kontributor aktiv në fushën e auditimit dhe kontabilitetit — jo thjesht si strukturë administrative, por si një institucion që duhet të përfaqësohet me dinjitet, i cili ka zërin e vet profesional, **mbron dhe promovon standardet etike e profesionale të çdo anëtari**.

Besoj se **transparenca dhe qëndrimet e balancuara** janë thelbësore për të forcuar respektin që ky institucion meriton në jetën publike dhe ekonomike të vendit. E shoh qëllimin tim për të qenë anëtar i Këshillit Drejtues (K.D.), si një kontributor në zhvillimin e mëtejshëm të organizatës tonë, duke vënë në shërbim përvojën profesionale, integritetin personal dhe përkushtimin ndaj vlerave që na bashkojnë. Rolin tim e konceptoj si një **bashkëbisedues aktiv dhe të sinqertë**, që dëgjon, kupton dhe përcjell zërin e kolegëve me respekt e përgjegjësi.

Gjatë ushtrimit të këtij funksioni, angazhohem të:

- **Mbështes çdo iniciativë që i shërbejnë interesit të përgjithshëm të anëtarësisë.**
- **Kontribuoj dhe mbështes në çdo iniciativë në forcimin e rolit institucional të IEKA-s.**
- **Promovoj transparencën dhe përgjegjshmërinë.**
- **Do të jem disponibël për cdo koleg.**

Ju faleminderit për durimin,

Albion Ndini

NDINI PARTNERS